



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 689
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Gjirkovc

E mërkurë: 18 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 17:45 – 19:00

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti si dhe asambleistët- Sanie Sadiku dhe Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryesuesi i Kuvendit Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Buxheti çdo vit, sikurse vitin e kaluar dhe vitet paraprake, e marrim dhe e bëjm nga kërkesat e qytetarëve. Ju e dini që dëgjimet publike i kemi filluar para 10 dite dhe tani i ka ardhur radha të jemi edhe në fshatin tuaj.

Ne sot jemi këtu për buxhetin e vitit 2026, ku do të flasim vetëm për investimet kapitale ku janë afërsisht 2.5 milion. Buxheti total është 11.5 milion dhe realisht është një ndër buxhetet më të mëdha që ka pasur Komuna e Shtimes që nga pas lufta. Realisht buxheti rritet me rritjen ekonomike në nivel vendi jo vetëm për Komunën e Shtimes por për të gjitha komunat. Mbi 50% të buxhetit shkon në paga dhe mëditje më pas i kem subvencionet, mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

Shtimja e ka pasur një fat të mirë që këto katër vite të sjell nga qeveria investime të shumta, të cilat janë madhore. Sa kemi ne buxhetin për investime kapitale për një vit, ne nga qeveria kemi marr aq vetëm për një projekt, pra jemi falënderues tej mase qeverisë dhe ministrave për të gjitha këto projekte të mëdha të cilat na i kanë mundësuar.

Para disa ditësh është nisur QKMF-ja e re, kemi projekte të tjera të cilat janë në ndërtim e sipër si: Stadiumi i Qyteiti, Enti Special, Unazat, Rrugët malore etj.

Ne sot jemi këtu që t'i marrim kërkesat për nevojat e juaja të cilat i keni në fshat, që ne t'i vendosim në buxhetin e vitit 2026.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Nazfi Sadriu:** Para Xhamisë dhe tek shkolla të asfaltohet.
Në rrugën “Arifi”, 2-3 shtëpia kanë nevoj për ndriçim.
Ndriçim nga rruga kryesore deri te fabrika.
Trotuari te rruga “Besim Sopa”.
- **Ragip Rexhepi:** Aneks i rrugës “Arifi”, të bëhet me ndriçim
- **Hysen Hoxha:** Rruga “Hoxhë Sinani” të lidhet me rrugën “ 17 Shkurti”, (4 metra gjerësi)
Kablla e cila është vendosur lartë, duhet të hiqet dhe të vendoses nër.
Trotuari dhe ndriçimi nga “Hoxhë Sinani”, deri te stacioni i autobusit.
Të zgjerohet rruga “Hoxhë Sinani” .
Vazhdimi i rrugës “Hoxhë Sinani”, (300m).
Park për fëmij në lagjen “Hoxhë Sinani”.
Rregullimi i shtratit të kanalit kullues.
- **Bajram Haxha:** Trotuari nga shkolla të vazhdoj.
Shkolla të rinovohet është prioriteti më i madh.
Në rrugën “Fehmi Agani”, trotuar dhe ndriçim.
- **Endrit Bajrami:** Asfaltim te një rrugë rreth shkollës (Rruga pa emër).

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Gjykojc
Date: 18.06.2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Rexhep Gashi	
2	HYSEN HAKHA	
3	Naf SADRIA	
4	Endrit Beqirani	
5	Djellon Beqirani	
6	XHAJIT AHMETI	
7	Julian JALILI	
8	FIKRET HURDINI	
9	Anton Rexhepi	
10	Arben Rexhepi	
11	Shqip Rexhepi	
12	Pegjo Rexhepi	
13	BAJRAM HAXHA	
14	FATON NUREDINI	
15	Gjyri Bgiri	
16		
17		